



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ITALIANE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Teknikë e Laborator i të Shkruarit

Ngarkesa: 4 kredite; 60 orë mësimore; 0 leksione / 60 seminare
Viti / Semestri : Viti I , semestri I
Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme
Programi i studimit: Bachelor – *Gjuhë, letërsi dhe qytetërim italian*
Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Ky kurs synon t'u japë mundësi studentëve të zhvillojnë kompetencën komunikative në të shkruar, duke u kujdesur për drejtshkrimin, gramatikën, shtrirjen tekstuale, kohezionin dhe koherencën, duke përmirësuar aftësinë e të shkruarit të teksteve të llojeve të ndryshme me vështirësi në rritjesi tekste informative, tekste përshkruese, tekste tregimtare, tekste argumentuese. Shkallët e kompetencës së lakmueshme për t'u arritur në fund të kursit ndryshojnë në varësi të nivelit të nisjes por gjithmonë në përputhje me KPERGJ (Kuadri i Përbashkët Evropian i Referimit per Gjuhët).

Objektivat specifike lëndore:

1. T'i aftësojë studentët që të shkruajnë një tekst të thjeshtë të natyrës informative, përshkruese, regulluese;
2. Të rrëfejë me shkrim një ngjarje në të cilën ka marë pjesë duke shprehur vlerësime në mënyrë të thjeshtë dhe koherente, ndjenja, opinione personale;
3. Të shkruajë tekste të shkurtra dhe të përmbledhura sipas kontekstit për të treguar momente të jetës së përditshme, familiare, shkollore;
4. Të shkruajë e-mail-e të thjeshta, fax-e, letra informale për të kërkuar apo për të dhënë informacione e shpjegime të sakta lidhur me tema të njohura;
5. Të përmbledhë qartë me shkrim një tekst të lehtësuar ose të thjeshtësuar të natyrave të ndryshme (letrare, historike); të nxjerrë në dukje vijimësinë logjike dhe kohore me anën e pyetjeve